

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08-381/1 dt. 26.03.2014**  
**PËR SHPALLJE TË NDRYSHIMEVE DHE PLOTËSIMEVE NË**  
**BUXHETIN E KOMUNËS DIBËR PËR v. 2014**

**205.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallen ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2014, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 12<sup>të</sup> dt.24.03.2014.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

206.Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për vetadministrim lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr 5 / 2002) dhe nenit 28 paragrafi 1 të Ligjit për financimin e vetadministrimit lokal (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007,156/2009 dhe 47/2011)

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 12<sup>të</sup> dt. 24.03.2014 solli:

**NDRYSHIME DHE PLOTËSIMET  
NË BUXHETIN E KOMUNËS  
DIBËR PËR v. 2014**

**1.PJESA E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Në Buxhetin e Komunës Dibër për v. 2014 bëhen këto ndryshime dhe plotësime :

	<b>BUXHET</b>	<b>REBALANC</b>
<b>I.TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME</b>	<b>257.261.000</b>	<b>284.439.000</b>
Të ardhurat tatimore	47.000.000	48.483.000
Të ardhurat jotatimore	14.600.000	16.768.000
Të ardhurat kapitale	16.300.000	20.300.000
Të ardhura prej dotacioneve	146.861.000	152.276.000
Transfere	31.500.000	31.500.000
Të ardhura nga donacione	1.000.000	15.112.000
<b>II.SHPENZIMET E PËRGJITHSHME</b>	<b>257.261.000</b>	<b>284.439.000</b>
Nga qëllimet e caktuara	256.861.000	284.039.000
Rezerva	400.000	400.000
<b>III. DEFICITI</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>IV. FINANCIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Hyrjet</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Të hyrat nga vëndi	0	0
Të hyrat nga jasht	0	0
<b>Daljet</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Pagesa kryesore	0	0

**Neni 2**

Të ardhurat e Buxhetit sipas llojeve të të ardhurave janë të përcaktuara në bilancin e të ardhurave, ndërsa shpenzimet sipas qëllimeve janë të përcaktuara në bilancin e shpenzimeve dhe atë si vijon:























































**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08-381/2 dt. 26.03.2014**  
**PËR SHPALLJE TË PROGRAMIT PËR AKTIVITETET**  
**HISTORIKE,KULTURORE DHE SPORTIVE NË TERRITORIN E**  
**KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014**

**207.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallet Programi për aktivitetet historike, kulturore dhe sportive në territorin e Komunës Dibër për vitin 2014, që Këshilli i Komunës e solli në seancën e 12<sup>të</sup> dt.24.03.2014.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**208.**Në mbështetje të nenit 27 paragrafi 1 pika 11 dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr. 14/03),  
Këshilli i komunës Dibër në seancën e 12<sup>të</sup> dt. 24.03.2014 solli:

**P R O G R A M**  
**PËR AKTIVITETE HISTORIKE, KULTURORE DHE SPORTIVE NË**  
**TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014**

Me këtë program parashifet organizimi i manifestimeve nga fusha e kulturës, sportit, historisë dhe ngjashëm për vitin kalendarik 2014 në territorin e Komunës Dibër.

**PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

- \* Informim për aktivitetet vjetore
- \* Të dhëna për propozim programin vjetor
- \* Qellimi kryesor i programit vjetor
- \* Aktivitetet e programit
- \* Programi i realizimit të aktivitetetve
- \* Plani kohor i aktiviteteve programore
- \* Buxheti

**Informim per aktivitetet zgjedhore**

Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër, në fillim të vitit kalendarik , harton PROGRAM vjetor për aktivitetet historike,kulturo-sportive për vitin në vijim gjegjësisht për vitin 2014 në të cilën pëlqim jep Kryetari i Komunës ndërsa sjellet nga Këshilli i Komunës.

Në Programin e planifikuar për vitin 2014, parshifen një sërë aktivitetesh historike, kulturo sportive që perkojnë me data te rëndësishme të historise, sportit dhe kulturës së lashtë të qytetit të Dibrës.

**Të dhënat për propozim programin vjetor**

Të gjitha aktivitetet e planifikuara do të mbahen në lokacionet dhe ambientet e Komunës Dibër.

**Programi** do të realizohet nga 01 janari deri më 31 dhjetori 2014.

Bartës i Programit është Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër.

**Manifestime**

Programe nga sferat e ndryshme kulturo-sportive

- Muzikë
- Folklor
- Teatër
- Ekspozita
- Turnir në futboll të vogël
- Turnir në basketboll

- Turnir në karate
- Gara në kajak
- Akademi shkencore
- Promovime të librave të botuara

Programi jep mundësi që aktivitetet konkrete të realizohen bazuar planifikimit të manifestimeve në qytetin e Dibrës për vitin 2014.

Me kete program, parashikohet që në ditët verore dhe gjatë tërë vitit në qytetin tonë të ketë një numër të konsiderueshem aktivitetesh që do ti pasqyrojnë të gjitha vlerat kulturore dhe historike të qytetit të Dibrës.

### **Qëllimet e përgjithshme të programit**

- Dhënie e mundësive për zhvillim kulturor dhe sportiv të komunës
- Promovim të vlerave tradicionale kulturore,historike dhe sportive dhe rëndësia e tyre në interes të zhvillimit të jetës në qytetin e Dibrës.
- Zhvillim të turizmit në qytet
- Zhvillim në aspektin e punësimeve të reja
- Sigurim të kushteve për qytetaret që të arrijnë deri te njohja e vlerave kulturore dibrane dhe përfitimi nga historija tradicionale lokale e qytetit të Dibrës.
- Krijim të vlerave të reja me të cilat krijohen kushte drejt zhvillimit ekonomik dhe kulturor në qytet.

### **Qëllimi konkret i programit vjetor**

Promovimi i vlerave kulturore,historike dhe ato sportive të qytetit të Dibrës përmes manifestimeve të ndryshme gjatë tërë vitit 2014.

### **Aktivitetet e programit**

#### **1. Programet muzikore**

- Koncert me Sh.K.A “Haki Stërmilli”
- Koncert me Sh.K.A.”Dibra”
- Dasma rome
- Koncert për të rinj
- Koncert kushtuar 28 Nëntorit ditës së flamurit kombëtar
- Koncert për Vitin e Ri

#### **2. Program teatror**

- Festivali i teatrit kombëtar
- Shfaqje teatrore
- Portiku poetik 2014
- Promovim librash të botuara

#### **3. Futboll**

- Turnir në futball të vogël
- Turnitr ne basketboll
- Gara në karate
- Gara në kajak
- Kros me shkollat e mesme dhe ato fillore.

#### **4. Akademi shkencore**

- Më datë 22 Shtator 2014, organizohet Akademi shkencore kushtuar “101 vjetorit të kryengritjes së Dibrës”

**BUXHETI**

<b>1</b>	<b>- Koncert me Sh.K.A “Haki Stërmilli”</b>	<b>122400</b>	<b>den.</b>
<b>2</b>	<b>- Koncert me Sh.K.A.”Dibra”</b>	<b>122400</b>	<b>den.</b>
<b>3</b>	<b>- Dasma rome</b>	<b>30000</b>	<b>den.</b>
<b>4</b>	<b>- Koncert për të rinj</b>	<b>30000</b>	<b>den.</b>
<b>5</b>	<b>- Koncert kushtuar 28 Nentori ditës së flamurit kombëtar</b>	<b>60000</b>	<b>den.</b>
<b>6</b>	<b>- Koncert për Vitin e Ri</b>	<b>50000</b>	<b>den.</b>
<b>8</b>	<b>- Festivali i teatrit kombatar</b>	<b>306000</b>	<b>den.</b>
	<b>- Shfaqje teatrore</b>	<b>30000</b>	<b>den.</b>
<b>9</b>	<b>- Portiku poetik 2014</b>	<b>60000</b>	<b>den.</b>
<b>10</b>	<b>- Turnir në futball të vogël</b>	<b>30000</b>	<b>den.</b>
<b>11</b>	<b>- Turnir në basketboll</b>	<b>30000</b>	<b>den.</b>
<b>12</b>	<b>- Gara në karate</b>	<b>60000</b>	<b>den.</b>
<b>13</b>	<b>- Gara në kajak</b>	<b>60000</b>	<b>den.</b>
<b>14</b>	<b>- Kros me shkollat e mesme dhe ato fillore.</b>	<b>30000</b>	<b>den.</b>
<b>15</b>	<b>- Akademi shkencore kushtuar 101 vjetorit të kryengritjes së Dibrës</b>	<b>180000</b>	<b>den.</b>
	<b>FINANCUES KOMUNA DIBËR</b>		
	<b>VLERA NË TOTAL</b>	<b>1.200.800,00</b>	<b>den.</b>

Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër mundet nëse paraqitet nevoja gjatë vitit 2014 të parashef dhe organizondhe aktivitete tjera nga këto fusha që nuk janë parapa me Programin me iniciativë të vet ose iniciativë të subjekteve tjerë, nëse sigurohen mjete financiare.

Për realizimin e këtij Programi do të kujdeset Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër.

Për realizimin e Programit vjetor do të kujdeset Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër.

Programi do të aplikohet nga 01 janar deri 31 dhjetor 2014 dhe do të shpallet në Kumtesën zyrtare të Komunës.

**Nr.07-339/4**  
**24.03.2014**  
**D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08-381/3 dt. 26.03.2014**  
**PËR SHPALLJE TË RREGULLORES PËR MËNYRËN**  
**DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË**  
**SALLËS SË SPORTIT NË QYTETIN E DIBRËS**

**209.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallet Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të sallës së sportit në qytetin e Dibërës, që Këshilli i Komunës e solli në seancën e 12<sup>të</sup> dt.24.03.2014.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**210.**Në mbështetje të nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e Komunës" nr. 14/03),

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 12<sup>të</sup> dt. 24.03.2014 solli:

**R R E G U L L O R E**  
**PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË SALLËS SË**  
**SPORTIT NË QYTETIN E DIBRËS**

**Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të Sallës e Sporteve të qytetit në Diber për aktivitete sportive të klubeve të rregjistruara në Federatat respektive si dhe manifestimeve të ndryshme kulturore, tubimeve partiake, si dhe rekreacionit.

**Neni 2**

Klubet dhe subjektet tjera të interesuara për shfrytëzimin e sallës sportive duhet që së paku 3 ditë para ditës së organizimit të manifestimit, tubimit apo ndeshjes t'i drejtohen me kërkesë Njesisë për veprimtari publike pranë Komunës Dibër të cilët janë të obliguar që të kthejnë përgjigje me shkrim brenda 48 orëve.

Klubet e rregjistruara tek **Njësia për veprimtari publike** pranë Komunës Dibër, dhe që janë të licencuara në Federatat respektive e që kanë kalendar të rregullt të garimit do të shfrytëzojnë sallën sportive sipas një orari të rregullt të rregulluar nga **Njësia për veprimtari publike**, në bashkëveprim me udhëheqësit e klubeve të komunës së Dibrës.

**Neni 3**

Të gjitha klubet sportive që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në palestër sportive dhe që janë të rregjistruara në Federatat respektive e që janë të Komunës së Dibrës, mund t'a shfrytëzojnë palestrën për stërvitje dhe garim në kuadër të sistemit të garimit të përcaktuara nga Federatat respektive mbështetur në këto kritere:

- a)për stërvitje sportive pa pagesë. ( 3 stërvitje në javë deri në ora 22.00)
- b)për zhvillimin e ndeshjeve pa bileta -pa pagesë
- c)për zhvillimin e ndeshjeve me bileta, 30% nga mjetet e inkasuara nga shitja e biletave.
- d) të gjitha klubet e shkollave, që u nënshtrohen rregullave të Federatave respektive nuk paguajnë 3 (tre) stërvitje në javë, ndërsa Shkollat private paguajnë sipas marreveshjes.

Salla e sporteve mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të tjera të ndryshme kulturo-sportive duke paguar:

- a)për aktivitete rekreative- sportive pa ndriçim-900,00 den. për një orë dhe aktivitete rekreative sportive me ndriçim - 1200,00 den. për një orë.
- b)për aktivitete dhe ngjarje komerciale (për një orë) 12000,00 den.
- c) për aktivitete dhe ngjarje jo komerciale(për një orë ) 6000,00 den.
- d) për aktivitete dhe ngjarje humanitare - pa pagesë



e)për koncerte 30% nga inkasimi i biletave ose pagesë fikse 60.000,00 den.

#### **Neni 4**

Të gjitha klubet sportive që nuk janë të Komunës së Dibrës mund ta shfrytëzojnë sallën sportive duke paguar shumën fikse prej 6000,00 den. për një orë shfrytëzimi.

#### **Neni 5**

Transmetimi i ngjarjeve nga salla prej kompanive televizive në rast se nuk janë ftuar nga subjekti që organizon aktivitetin, paguajnë tarifë fikse 6000,00 den. për transmetim.

#### **Neni 6**

Reklamat lëvizëse të sponsorëve të klubeve mund të ekspozohen vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre ,ndërsa për reklama statike paguhet tarifa bazuar marreveshjeve paraprake.

#### **Neni 7**

Prej të gjitha obligimeve financiare lirohen organizimet shtetërore që bën Komuna për Festa Shtetërore e Kombëtare, qofshin ato me karakter kulturor apo sportiv, por nëse organizatori nuk përfiton nga shitja e biletave.

Me ndonjë arsye të veçantë nga pagesa mund të lirohet ndonjë subjekt si: Shoqatat e të perndjekurve dhe te burgosurve politik, Shoqatat të dala nga luftrat dhe personat me aftësi të veçanta, por pas aprovimit nga Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër.

#### **Neni 8**

Në Sallen sportive ndalohet bartja e armëve dhe mjeteve të tjera eksplozive, pirja e duhanit, dhe alkoolit, dhe personat që thyejnë këtë rregull largohen nga Salla e sportive prej personave për siguri.

#### **Neni 9**

Dëmet e regjistruara gjatë ushtrimeve ose lojërave zyrtare vlerësohen nga një Komision prej 3 (tre) anëtarëve që formohet nga Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër dhe ky komision përpilon procesverbal të posaçëm për dëmet e regjistruara.

Me dëmet e regjistruara nga komisioni i formuar, ngarkohet klubi ose subjekti që ka qenë i ngarkuar me përgjegjësi dhe ka shfrytëzuar sallën e sportit në kohën e shkakimit të atyre dëmeve i cili është i obliguar që në afat prej 7 ditësh t'i kompensojnë ato.

Në rast të mos kompensimit të dëmeve siç parasheh komisioni, klubit a subjektit përgjegjës i ndalon aktivitetin në sallën e sportit, ndërsa Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër e përcjell procedurën në institucionet gjyqësore .

#### **Neni 10**

## **Nr.12/25.03.2014 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 408**

Për shfrytëzimin e sallës së sportit , klubet dhe subjektet tjera që kanë orar të rregullt të shfrytëzimit të këtij objekti, nënshkruajnë marrëveshje me Njësinë për veprimtari publike pranë Komunës Dibër mbështetur në këtë Rregullore.

### **Neni 11**

Inkasimi i mjeteve financiare nga aktivitetet e ndryshme sipas nenit 3,4 dhe 5 të Rregullores bëhet në këtë mënyrë:

- klubet apo subjektet e ndryshme që do të shfrytezojnë sallën e sportit së pari bëjnë rezervimin në ditar tek personeli i sallës sportive, njëherit bëjnë pagesën e duhur me anë të bllokut kasa-pranoi të cilin bllok personeli i sallës e pranon nga Njësia për veprimtari shoqerore duke i dorëzuar paguesin llogari fiskale. Personi i palestres i cili pranon pagesën, për ç' do ditë gjegjësisht një ditë më pas me anë të virmanit hudh mjetet e inkasuara në zhirollogarinë përkatëse të Komunës :
- Llogaria e trezorit : 100000000063095
- Llogaria e shfrytëzuesit të buxhetit : 7180140304 630 16 dhe
- Shifra : 723911 00

### **Neni 12**

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës së njëjtë për sjelljetësaj.

### **Neni 13**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Njësia për veprimtari publike pranë Komunës Dibër, ndërsa Kryetari i Komunës e përcjell implementimin e saj.

### **Neni 14**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Kumtesën zyrtare të Komunës.

**Nr.07-339/5**  
**24.03.2014**  
**D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**P Ë R M B A T J A**

205	Konkluzion për shpallje të ndryshimeve dhe plotësimeve të Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2014	_____	375
206	Ndryshime dhe plotësime të Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2014	_____	376
207	Konkluzion për shpallje të Programit për aktivitetet historike, kulturore dhe sportive në territorin e Komunës Dibër për vitin 2014	_____	401
208	Programi për aktivitetet historike, kulturore dhe sportive në territorin e Komunës Dibër për vitin 2014	_____	402
209	Konkluzion për shpallje të Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të sallës së sportit në qytetin e Dibrës	_____	405
210	Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të sallës së sportit në qytetin e Dibrës	_____	406

**PËRGATITI: SHËRBIMI PRANË KËSHILLIT TË KOMUNËS**

---

---